



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Nr. 05 Prot

Datë, 11.03.2020

VENDIM

Nr.1, datë 11. 03. 2020

PËR

**KRYERJEN E DETYRAVE FUNKSIONALE TË KOMISIONIT INSTITUCIONAL
ZGJEDHOR PËRMES KOMUNIKIMIT TELEFONIK DHE ELEKTRONIK**

Në mbështetje të shkronjave a dhe b të nenit 6, (Kreu II), të Rregullores "Për organizmin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë", të VKM nr. 208, datë 10. 03. 2020, Urdhërit nr. 135, datë 09. 03. 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Urdhërit nr. 91, datë 09. 03. 2020 të Ministres së MASR, Urdhërit nr. 20, datë 09. 03. 2020 dhe Urdhërit nr. 21, datë 10. 03. 2020 të Rektorit, në funksion të mbarëvajtjes së procesit zgjedhor institucional, në kushtet e zbatimit të masave për parandalimin e përhapjes së infeksionit nga COVID-19, si dhe në pamundësi për të patur komunikim shkresor me trupat zgjedhore dhe kandidatët për autoritete drejtuese dhe organe drejtuese në UV Komisioni Institucional Zgjedhor,

VENDOSI:

1. Të miratojë çeljen e adresës elektronike të Komisionit Institucional Zgjedhor kiz@univlora.edu.al, që do të përdoret për njoftim e komunikim në funksion të drejtimit dhe kontrollit të procesit zgjedhor.
2. Të miratojë kryerjen e detyrave funksionale të Komisionit Institucional Zgjedhor dhe komunikimin me personelin akademik, studentët, njësitë dhe strukturat e tjera, përmes formave telefonike dhe elektronike.
3. Të bëjë regjistrimin e anëtarëve të personelit akademik që vetëkandidojnë për anëtarë të Komisioneve të Zgjedhjeve në Fakultete (KZF), kundrejt kërkesës dërguar prej tyre në adresën elektronike kiz@univlora.edu.al.
4. Vendimi publikohet në faqen web www.univlora.edu.al.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetar i Komisionit Institucional Zgjedhor
Oljana Hoxhaj**

Anëtarët

Shkelqim Sinanaj

Eljona Zanaj

Evis Allushi

Kristi Mucollari